

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SUNS’S MIRACLE” SHPK**

Ortaku themelues:

- **Z. Kreshnik Rapush Gjata**, shtetas shqiptar, lindur më 05.11.1975 ne Fier, banues në Fier, lagjja Bishanak, rruga “Nezir Frakulla”, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033795727 dhe numër personal H51105015U;

bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 23.10.2020, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

**NENI 1**  
***Emri***

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “SUN’S MIRACLE” SHPK.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

**NENI 2**  
***Forma***

2.1 Shoqëria tregtare “SUN’S MIRACLE”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**  
***Zyra Qendrore***

3.1 Zyra Qendrore e Shoqërisë ndodhet në adresën: lagjia Liri, rruga “Jakov Xoxa” pallati 5 katësh përballë aziles, kati 1, Fier.

3.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

**NENI 4**  
***Objekti i Veprimtarisë***

4.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

C. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike fotovoltaike dhe gjithë llojeve te tjera te prodhimit te energjise dhe veprave ndihmese ne gjithë territorin e Shqiperise;

D. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

4.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten leje, licenca dhe/ose autorizime përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve.



**NENI 5**  
***Kohëzgjatja***

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**  
***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

6.1 Shoqëria tregtare "SUN'S MIRACLE" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
***Përgjegjësia e Ortakut***

7.1 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "SUN'S MIRACLE" SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

**NENI 8**  
***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "SUN'S MIRACLE" SHPK është 100.000 (njëqind) lekë .

8.2 Ortaku i Vetëm i shoqërisë është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm z. Kreshnik Gjata.

**NENI 9**  
***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një ose dy administratorë që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i parë i Shoqërisë është z. Kreshnik Gjata.

***Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe***

**ORTAKU THEMELUES  
KRESHNIK GJATA**

*Kreshnik Gjata*

